



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:124679
Datë: 27.01.2025
Numri i dokumentit: 06762084

ARJ.nr.138/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani, kryetar, Zenel Leku dhe Nenad Lazić anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, F.I., nga, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Hajzer Salihu, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPM SHCK), me seli në P., me bazë juridike anulim i aktit administrativ – vendimit të paditurit, A.nr.301/2021, të datës 20.05.2021, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit, ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.398/2023 të datës 11.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21 Janar 2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi F.I., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit - Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA.nr.398/2023, të datës 11.07.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së Apelit, AA.nr.398/2023 të datës 11.07.2024, është vendosur si në vijim: Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit F.I., nga P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.1346/2021, i datës 05.04.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AA.nr.398/2023 të datës 11.07.2024, paditësi për mes të autorizuarit të lartë shënuar në afat ligjor në këtë gjykatë parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të: APROVOHET në tërësi kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të ANULOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr.398/2023, të datës 11.07.2024 dhe ai i Gjykatës Themelore në Prishtinë

A.nr.1346/2021, i datës 05.04.2023, dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit apo çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit nuk ka ushtruar pala e paditur.

Gjykata Supreme, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe atij të shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë (KPMSHCK), me vendim A.nr.301/2021, të datës 20.05.2021, Shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.301/2021 të datës 26.04.2021 të parashtuar nga ankuesi F. I., me arsyetimin se i njëjti nuk është nëpunës civil. Në arsyetim të vendimit ka theksuar se: Në bazë të dëshmive të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ankuesi nuk është pranuar në shërbimin e jashtëm në gradën ambasador nëpërmjet një konkursi të hapur dhe nuk ka nënshkruar akt emërim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, ngase krijimi i marrëdhënies së punës së ankuesit është bërë sipas Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, nr.156/2020 të datës 29.10.2020. Andaj, në mbështetje të nenit 3 par.4 dhe nenit 4 par. 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, 7 par. 7.1, 7.8, 7.10 të Ligjit Nr.03/L-207 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, nenit 20 të Ligjit nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtëm dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, vendosi si në dispozitiv të vendimit të saj sepse i njëjti nuk e ka statusin e shërbyesit civil.

Kundër vendimit të lartë cekur të KPMSHCK paditësi me padi fillon konflikt administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin A.nr.1346/2021, të datës 05.04.2023, ka vendosur si në vijim: I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit F.I., nga P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Hajzer Salihu, avokat nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi A.nr.301/2021 i datës 20.05.2021 i të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj arsyeton ndër të tjera se: Gjykata e shkallës së parë konstatoi se vendimi i të paditurit nuk është në kundërshtim me nenin 47, 48 dhe 132 të LPPA-së. Gjykata e shkallës së parë i vërtetoi si të drejta dhe të bazuara në ligj të gjitha gjetjet faktike të organit të paditur dhe për të njëjtat konstatoi se janë të bazuara në ligjin material, ashtu sikurse të njëjtat janë të ndërlidhura me çështjen juridike të paditësit. Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë vërtetoi gjetjet e kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave se paditësi nuk posedon Akt emërim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, sepse emërimi i tij ka qenë direkt në mision me vendim të ministrit, kështu duke ia bashkëngjitur edhe vendimin me

numër të referencës 127/13 të datës 20.03.2013 të Ministrisë së Punëve të Jashtme, andaj gjykata e shkallës së parë gjeti se organi i paditur me të drejtë ka konstatuar se paditësi nuk e ka statusin e shërbyesit civil.

Në referim të nenit 3 paragraf 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *“Personeli diplomatik dhe konsullor, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi”*, dhe nenit 4 paragraf 1 të këtij Ligji, ku është përcaktuar se: *“Në bazë të këtij Ligji, statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e më poshtme:...të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale”*, gjykata vlerësoi se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike dhe juridike.

Gjykata e shkallës së parë refuzoi pretendimet e paditësit të dhëna në padi, si të pa argumentuara dhe pa asnjë mbështetje në ligjin material apo në gjendjen faktike. Andaj, në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë, e ka refuzuar si të pabazuar padinë e paditësit dhe në bazë të nenit 5, 6, 38 43, 46.2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit, me aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse në kuptim të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA)-së dhe 194 të Ligji për Procedurën Kontestimore (LPK)-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj si më lartë. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në shkaqet dhe arsyet po ashtu të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe drejtë është aplikuar e drejta materiale me refuzimin e kërkesëpadsisë së paditësit. Pretendimet ankimore të paditësit lidhur me shkeljen e dispozitave të procedurës, kolegji i kësaj gjykate i ka refuzuar si të pabazuara duke konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike se gjykata e shkallës së parë në mënyrë jo të drejtë i ka injoruar faktet e paraqitura në padi duke vërtetuar një gjendje faktike krejtësisht tjetër nga ajo që është kërkuar me anë të padisë, këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase konsideron se të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate vendimi i kontestuar i të paditurit dhe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura, dhe si i tillë aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, në kuptim të dispozitave nga neni 49 të LKA-së, nenit 200 të LPK-së, lidhur me nenin 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar dhe akteve të lëndës gjen, se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vendosur me refuzimin si të pabazuar të ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit por edhe të Gjykatës Themelore, në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë meqë aktgjykimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës apo të drejtës materiale, ashtu si pretendon pala paditëse në kërkesën e tij. Aktgjykimet e kontestuara përmbajnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, nga rezulton se drejtë është vërtetuar gjendja faktike me refuzimin si të pabazuar të kërkesë padisë së paditësit.

Bazuar në provat e administruara për mes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve, me të drejtë ka rezultuar se vendimi i të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), A.nr.301/2021, të datës 20.05.2021 me të cilin shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën datës 26.04.2021, të parashtruar nga paditësi, është vendim i drejtë dhe i ligjshëm. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 3 par.4, neni 4 par.1, dhe 19 par.1 të Ligjit për Shërbimin Civil Nr.03/L-149 i Republikës së Kosovës, paditësi nuk e gëzon statusin e nëpunësit civil. Nga paditësi nuk provohet se posedon akt emërim nga MPJ dhe Diasporës, i njëjti nuk është pranuar në pozitën, gradën e Ambasador për mes konkursit të hapur dhe procedurës konkurruese, por emërimi i tij është bërë për mes dekretit nr. 156/2020 të dt. 29.10.2020. Paditësi nuk e ka statusin e nëpunësit civil, edhe në bazë të nenit 3 parë 2 nën par 2.3 të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtar Publik, sepse sipas par. 2.3 përcaktohet se, ky ligj nuk zbatohet për funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo Presidenti i Republikës. Po ashtu vendimi i të paditurit, gjen mbështetje edhe në dispozitat ligjore nga neni 8 i Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtëm dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës sipas pozitës të cilën e posedon paditësi, sipas së cilës parashihet se anëtarët e shërbimit diplomatik, për veç të emëruarve politik, janë pjesë e shërbimit civil.

Pretendimet e paditësit të theksuara si në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ku ndër të tjera theksohet se: gjykatat e instancave më të ulëta kanë interpretuar gabimisht të drejtën materiale, duke u bazuar vetëm në një fakt të vetëm se paditësi është emëruar me vendim të ministrit dhe jo me akt emërim, pasi dispozitat e veçanta përkatësisht aktet nënligjore si UA.nr.3/2009 dhe UA.nr.02/2012, kanë paraparë se anëtarët e shërbimit diplomatik të karrierës kanë statusin e veçantë të shërbyesit civil dhe ata emërohen me vendim të Ministrit e jo me akt emërim siç bëhet për nëpunësit civil të rregullt. Kolegji i Gjykatës Supreme i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzon si të pabazuara dhe jo të qëndrueshme sipas çështjes së shqyrtuar dhe vendosur. Gjykata e vlerëson si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta, si në aktgjykimet e tyre dhe organi i paditur si në vendimin e tij, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ishte emëruar në gradën diplomatike në shërbim të jashtëm dhe kërkesa e tij për realizimin e pagës sipas pozitës në të cilën është emëruar e dt. 26.04.2021, ashtu si u theksua si më lartë nuk është pozitë si shërbyes civil andaj me të drejtë i paditur KPMSHCK është shpallur jo kompetent për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesën e tij, A nr. 301/2021 të dt. 26.04.2021. Për deri sa më parë, ishte pranuar në MPJ dhe kishte ushtruar detyrat mbi bazën e vendimit me nr.ref.127/13 të datës 20.03.2013 të Ministrit të MPJ-

së, duke ju caktuar grada diplomatike “Këshilltar”, i caktuar të shërbej në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Belgjikë-Bruksel si punonjës i ri dhe pozita tjera të më vonshme si anëtar i personelit diplomatik, në harmoni me Ligjin nr. 03//L-044 për MPJ përkatësisht nenin 8.1, si pjesë e shërbimit civil, deri në fitimin e gradës diplomatike me datë 26.04.2021.

Gjykata thekson se në vështrim të dispozitave ligjore të lartcekura emërimi i nëpunësve civil në pozita të karrierës është paraparë të ndodhë pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një akti të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike, në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil, e të cilin akt duhet ta nënshkruaj udhëheqësi më i lartë i institucionit dhe kandidati i përzgjedhur. Në rastin konkret kjo procedurë nuk rezultoi të jetë zhvilluar për paditësin. Në nenin 19.1 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të këtij ligji është përcaktuar se “Nëpunësit civil themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike, në të cilën do të gjejë punë nëpunësi i ri civil”.

Pretendimet e paditësit si në kërkesë, ku ndër të tjera i referohet praktikës së kësaj gjykate, përkatësisht aktvendimit ARJ-UZVP.nr.115/2022 të datës 09.11.2022, me të cilin ishte anuluar aktvendimet e gjykatave të instancave më të ulëta dhe çështja i ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë, kolegji i kësaj gjykate i shqyrtoi dhe të njëjtat i refuzoi si të pabazuara. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin A.nr.1687/22, të datës 05.07.2022, ishte shpallur jo kompetente për të gjykuar, me arsyetimin se konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet kundër akteve administrative të cilave i është ofruar mbrojtje gjyqësore, sipas Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimit Diplomatik të Republikës së Kosovës. Ndërsa, ky aktvendim ishte vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit, AA.nr.597/22, të datës 25.08.2022. Kjo gjykatë, me aktvendimin në të cilin thirret paditësi, ka anuluar dy aktvendimet e gjykatave të instancave më të ulëta, me arsyetimin se të njëjtit janë të përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, sepse në aktvendimet e tyre nuk kanë arsyetuar se mbi bazën e cilave prova dhe fakte vendimtare e kanë bazuar vendimmarrjen e tyre dhe jo siç pretendon paditësi në kërkesë.

Pretendimet lidhur me shkeljen e dispozitave të procedurës nga neni 182 par. 2, pika (n) dhe 160 të LPK-së, nga gjykata e shkallës së dytë, kolegji i gjykatës Supreme po ashtu i refuzon si të pabazuar dhe jo të qëndrueshme. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktvendimit të kontestuar janë dhënë mjaft arsye lidhur me faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, gjykata vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë dhe nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Pretendimi se organi punëdhënës i paditësit MPJ, në këshillën juridike të vendimit të saj e ka udhëzuar paditësin që të ankohej në KPMSHCK, si dhe se ende nuk ka ndonjë vendim përfundimtar se kush është organi kompetent për të shqyrtuar kërkesat e anëtarëve të shërbimit diplomatik, si dhe detyrimin e KPMSHCK-së që konform nenit 75 të LPPA-së ta delegoj tek

organi kompetent, kolegji i Gjykatës Supreme e refuzoi si të pabazuar dhe të pa qëndrueshëm, nga se nuk ka mundur të gjej zbatim dhe të aplikohet dispozita e nenit 75 par.1 të LPPA-së që ky organ ankesën t'ia kaloj organit kompetent, pasi që lidhur me ankesën e paditësit të parashtruar tek organi i paditur nuk ka qenë kompetent ndonjë organ tjetër administrativ. Atakimi i akteve administrative përfundimtare nga nëpunësit civil bëhet në procedurën e konfliktit administrativ, ndërsa kur marrëdhënia e punës është e rregulluar me ligje tjera, ata mund ta atakojnë dhe të kërkojnë mbrojtje gjyqësore në gjykatën kompetente në kontest civil.

Nga parashtrimet si më lartë, e në bazë të nenit 54 par.1 të Ligjit për Konflike Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME - PRISHTINË
ARJ.nr.138/2024, më datë 21 Janar 2025

B. Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani